



KUVENDI

PROJEKTLIGJ

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2026

**PËR MASAT PËR ZVOGËLIMIN E KOSTOVE TË NDËRTIMIT TË RRJETEVE TË KOMUNIKIMEVE ELEKTRONIKE ME KAPACITETE SHUMË TË LARTA - AKTI I INFRASTRUKTURËS GIGABIT<sup>1</sup>**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë,

**V E N D O S I:**

**KREU I**

**DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1**  
**Qëllimi**

1. Ky ligj ka për qëllim të lehtësojë e nxisë ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), duke promovuar përdorimin e përbashkët të infrastrukturës fizike ekzistuese dhe një zhvillim më efikas të infrastrukturës fizike të re, nëpërmjet ndërtimit më shpejt dhe me kosto më të ulët të këtyre rrjeteve.
2. Ky ligj përcakton kërkesat minimale për arritjen e qëllimit sipas pikës 1, të këtij neni.

<sup>1</sup> Ky projektakt është i përafuar me Rregulloren e (BE) 2024/1309 e Parlamentit Evropian dhe e Këshillit, e datës 29.4.2024, për masat për reduktimin e kostove për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike gigabit, që amendon Rregulloren e BE 2015/2120, dhe shfuqizon Direktivën 2014/61/EU (Akti i Infrastrukturës Gigabit); Numri CELEX 32024R1309, Gazeta Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 349, datë 8.5.2024, p. 1–40

## Neni 2 Fusha e zbatimit

1. Ky ligj zbatohet për operatorët/sipërmarrësit që veprojnë në fushën e komunikimeve elektronike, me qëllim ndërtimin e rrjetit të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta, si dhe për operatorët e rrjeteve dhe organet e sektorit publik që ofrojnë infrastrukturë fizike sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. Detyrimet e përcaktuara në këtë ligj për sipërmarrësit, në lidhje me rrjetet e komunikimeve elektronike, në asnjë rast nuk përjashtojnë detyrimet që bëjnë nga ligji nr. 54/2024 datë 30.5.2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

## Neni 3 Përkufizime

I. Termat e përdorur në këtë ligj për: "rrjetin e komunikimeve elektronike", "rrjetin me kapacitet shumë të lartë", "rrjetin publik të komunikimeve elektronike", "pikë fundore e rrjetit", "facilitetet shoqëruese", "përdorues fundor", "siguria e rrjetit dhe shërbimeve", "akses" dhe "operator", kanë të njëjtin kuptim me përkufizimet e ligjit nr. 54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

II. Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Operator rrjeti" nënkupton:

- a) një operator, sipërmarrës që ofron ose është i autorizuar të ofrojë rrjete të komunikimeve publike, sipas ligjit për komunikimet elektronike;
- b) çdo sipërmarrës që ofron infrastrukturë fizike të destinuar për ofrimin e:
  - i) shërbimit të prodhimit, transportit ose të shpërndarjes së:
    - gazit;
    - energjisë, përfshirë edhe ndriçimin publik;
    - ngrohjes;
    - furnizimit me ujë, përfshirë kanalizimet ose trajtimin e ujërave të ndotura dhe të zeza, si dhe sistemin e drenazhimit;
  - ii) shërbimeve të transportit, duke përfshirë hekurudhat, rrugët, portet dhe aeroportet.

2. "Organ i rregulluar nga e drejta publike" do të thotë një organ që ka të gjitha karakteristikat e mëposhtme:

- a) është themeluar për qëllimin specifik të përmbushjes së nevojave në interes të përgjithshëm, që nuk kanë karakter industrial ose tregtar;
- b) ka personalitet juridik;
- c) financohet, plotësisht ose për pjesën më të madhe, nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale ose nga organe të tjera të rregulluara nga e drejta publike, ose i nënshtrohet mbikëqyrjes së menaxhimit nga këto autoritete ose organe; ose ka një bord administrativ, menaxherial ose mbikëqyrës, më shumë se gjysma e anëtarëve të të cilit emërohen nga autoritetet shtetërore, rajonale ose lokale, ose nga organe të tjera të rregulluara nga e drejta publike;

3. "Organ i sektorit publik" do të thotë një autoritet shtetëror, rajonal ose lokal, një organ i rregulluar nga e drejta publike ose një shoqatë e formuar nga një ose më shumë autoritete të tilla, ose një ose më shumë organe të tilla të rregulluara nga e drejta publike;

4. "Infrastrukturë fizike" është:

- a) çdo element i një rrjeti, i cili ka për qëllim të hostojë elemente të tjera të një rrjeti, pa u bërë vetë një element aktiv i tij, siç mund të jenë tubacionet, kanalet/gypat, pusetat, kabinetet, instalimet e

antene, kullat dhe shtyllat, si dhe ndërtesat, duke përfshirë çatitë e tyre dhe pjesë të fasadave ose hyrjeve në ndërtesa dhe çdo aset tjetër, duke përfshirë pajisjet rrugore si shtyllat e ndriçimit, tabelat e rrugës, semaforët, tabelat e reklamave, të pagesave në rrugë "tolls", si dhe stacionet e autobusëve, tramvajeve dhe stacionet e metrosë dhe hekurudhës;

b) kur nuk janë pjesë e një rrjeti dhe janë në pronësi ose të kontrolluara nga organet e sektorit publik: ndërtesat, përfshirë çatitë e tyre dhe pjesë të fasadave ose hyrjeve të ndërtesave, dhe çdo aset tjetër, duke përfshirë pajisjet rrugore, siç janë shtyllat e dritave, tabelat e rrugës, semaforët, tabelat e reklamave dhe pagesave "tolls", si dhe stacionet e autobusëve dhe tramvajeve dhe stacionet e metrosë dhe hekurudhave.

Kabllo, përfshirë fibrat e papërdorura "dark fiber", si dhe elemente të tjera të rrjeteve, të përdorura për furnizimin me ujë të pijshëm, nuk konsiderohen infrastrukturë fizike, sipas këtij ligji.

5. "Punime civile", është çdo rezultat i punimeve të ndërtimit ose punime civile inxhinierike të marra në tërësi, të cilat, në vetvete, janë të mjaftueshme për të përmbushur një funksion teknik apo ekonomik dhe që përfshijnë vendosjen e një ose më shumë elementeve të infrastrukturës fizike.

6. "Infrastrukturë fizike në godinë", është infrastruktura fizike ose instalimet në vendndodhjen e përdoruesit fundor, duke përfshirë elemente në pronësi të përbashkët, që hostojnë rrjetet kablore ose pa tel (wireless), aksesit në të cilat ka aftësinë të shpërndajë shërbimet e komunikimeve elektronike dhe të lidhë pikën e aksesit të godinës me pikën fundore të rrjetit.

7. "Instalime me fibra brenda ndërtesës", do të thotë kabllo me fibra optike në vendndodhjen e përdoruesit fundor, duke përfshirë elementët në pronësi të përbashkët, të destinuara për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike dhe që lidhin pikën e aksesit të ndërtesës me pikën fundore të rrjetit;

8. "Infrastruktura e godinës, e gatshme për fibra", është infrastruktura fizike brenda godinës, e destinuar për hostimin e elementeve me fibra optike.

9. "Punë të mëdha rinovimi", do të thotë punime civile në vendndodhjen e përdoruesit fundor që përfshijnë modifikime strukturore të të gjithë infrastrukturës fizike brenda ndërtesës ose të një pjese të rëndësishme të saj dhe që kërkojnë, një leje ndërtimi sipas legjislacionit kombëtar në fuqi;

10. "Leje", do të thotë një vendim i qartë ose i nënkuptuar ose disa vendime të marra njëkohësisht, ose në mënyrë të njëpasnjëshme nga një ose më shumë autoritete kompetente, të cilat kërkojnë sipas legjislacionit në fuqi që një sipërmarrës të kryejë punime ndërtimi ose civile të nevojshme për vendosjen e elementëve të VHCN-ve;

11. "Pikë e aksesit në godinë", është një pikë fizike, e vendosur brenda ose jashtë godinës, e aksesueshme nga sipërmarrësit që ofrojnë, ose janë të autorizuar që të ofrojnë, rrjete publike të komunikimit dhe ku realizohet lidhja e infrastrukturës fizike brenda godinës e gatshme për fibra.

12. "E drejta e kalimit", nënkupton të drejtat e referuara në nenin 57, të ligjit nr.54/2024 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", të dhëna një operatori për instalimin në, mbi ose nën një pronë publike ose private, të elementëve për zhvillimin e rrjetit me kapacitet shumë të lartë (VHCN) dhe faciliteteve shoqëruese.

13. "Autoritet rregullator", është Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), që funksionon si organ rregullator i pavarur për komunikimet elektronike sipas përcaktimeve të ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë".

14. "Autoriteti planifikues", është autoriteti kompetent për dhënien e lejeve të ndërtimit, sipas përcaktimeve në ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

15. "Autoritete përgjegjëse", janë organet dhe institucionet e administratës shtetërore, të ngarkuara për përmbushjen e detyrimeve rregullatore që rrjedhin nga ky ligj, brenda kompetencave të tyre.

16. "Ministri", është ministri përgjegjës për komunikimet elektronike.

17. "Pika e vetme e informacionit", është pika që siguron marrjen e informacionit nga Sistemi i Përqendruar i Informacionit mbi infrastrukturën e operatorëve të rrjetit.

18. "Pronë e shtetit", është prona e paluajtshme e shtetit, publike dhe jopublike, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar.

19. "Pronë private", është prona e paluajtshme, që nuk përfshihet te pronat e paluajtshme të shtetit, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, dhe është në pronësi të një subjekti privat.

20. "Prona shërbyese", është prona e shtetit ose private, mbi të cilën shtrihet e drejta e kalimit.

21. "Sipërmarrës i komunikimeve elektronike", është subjekti fizik apo juridik, që ofron ose është i autorizuar për të ofruar rrjete të komunikimeve elektronike.

22. "Sistem i përqendruar i informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike", është portali GIS i infrastrukturës së komunikimeve elektronike, i administruar nga AKEP-i, që siguron publikimin dhe përditësimin elektronik të informacionit për infrastrukturën e komunikimeve elektronike dhe garanton aksesin e sipërmarrësve të ky informacion, në përputhje me këtë ligj.

## KREU II

### AKSESI NË INFRASTRUKTURËN FIZIKE EKZISTUESE

#### Neni 4

##### E drejta për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese

1. Çdo operator ka të drejtë të paraqesë kërkesë për akses në infrastrukturën ekzistuese të një operatori, rrjeti dhe organi të sektorit publik, që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike, me qëllim arritjen e një marrëveshje aksesi për vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), ose faciliteteve shoqëruese të tyre.
2. Çdo operator ka të drejtë të ofrojë akses në infrastrukturën e tij fizike, me qëllim vendosjen e rrjeteve, përveç rrjeteve të komunikimeve elektronike ose faciliteteve shoqëruese të tyre.
3. Një operator rrjeti ose një organ i sektorit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike, me marrjen e një kërkesë me shkrim nga një operator, plotëson të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses në infrastrukturën e tij fizike, në terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme, me qëllim vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete shumë të larta (VHCN), ose facilitetet shoqëruese të tyre.
4. Organet e sektorit publik që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike, përmbushin kërkesat e arsyeshme për akses sipas pikës 3, të këtij neni, në kushte dhe terma jodiskriminuese.
5. Çdo operator rrjeti, duhet të vlerësojë mundësinë e plotësimit të kërkesës për akses në infrastrukturën e tij fizike, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Vlerësimi bëhet mbi bazën e trajtimit në kushte të drejta, duke përfshirë çmimin, me qëllim zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë.

#### Neni 5

##### Kërkesa për akses në infrastrukturën fizike ekzistuese

1. Kërkesa për akses, sipas nenit 4, të këtij ligji, bëhet me shkrim, pranë operatorit të rrjetit ose pranë organit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike.
2. Në kërkesën për akses operatori kërkues specifikon elementet e rrjetit për të cilin kërkohet aksesi, duke përfshirë dhe periudhën kohore për të cilën kërkohet aksesi. Kërkesa shoqërohet

- me dokumentacionin e kërkuar dhe të publikuar nga operatori i rrjetit, ose organi publik për këtë qëllim, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
3. Operatori i rrjetit dhe organet e sektorit publik apo subjekti juridik ku është paraqitur kërkesa për akses, duhet t'i kthejë përgjigje operatorit kërkuar për mundësitë e dhënies ose jo, të aksesit në infrastrukturën e tij fizike, jo më vonë se një muaj nga data e marrjes së saj.
  4. Me marrjen e kërkesës për akses nga një operator rrjeti, personat juridik qiramarrës ose mbajtës të të drejtave të tjera përveç të drejtave të pronësisë, mbi pronën/tokën ku planifikohet të instalohen ose janë instaluar facilitete me qëllim zhvillimin e elementëve të rrjeteve me kapacitete shumë të larta (VHCN), ose subjektet që menaxhojnë kontratat e qirasë në emër të pronarëve të tokës dhe operatorët, negociojnë në mirëbesim për aksesin në këtë pronë/tokë, duke përfshirë çmimin, i cili pasqyron kushtet e tregut, kur është e përshtatshme në përputhje me legjisllacionin në fuqi për kontratat.
  5. Operatorët dhe/ose personat juridikë sipas përcaktimeve në pikën 4, të këtij neni, informojnë autoritetin rregullator për arritjen e marrëveshjes së aksesit, duke informuar dhe për çmimin e aksesit.

## Neni 6

### Kushtet e drejta dhe të arsyeshme për akses

1. Operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike, ofrojnë aksesin në kushte të drejta dhe jo diskriminuese, përfshirë çmimin e aksesit.
2. Në përcaktimin e kushteve të drejta dhe të arsyeshme, duke përfshirë çmimin për dhënien e aksesit, me qëllim shmangien e çmimeve ekstremisht të larta, operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik mbajnë parasysh:
  - a) kontratat ekzistuese dhe kushtet tregtare të dakordësuara ndërmjet operatorit kërkuar të aksesit dhe operatorit të rrjetit, ose organit të sektorit publik si dhënës i aksesit në infrastrukturën fizike;
  - b) nevojën për të siguruar që ofruesi i aksesit të ketë një mundësi për mbulimin e drejtë të kostove për dhënien e aksesit në infrastrukturën e tij fizike, duke marrë parasysh kushtet specifike kombëtare, modelet e biznesit dhe çdo strukturë tarifore të vendosur për të ofruar një mundësi të drejtë për mbulimin e kostove; në rastin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, duke marrë gjithashtu në konsideratë çdo masë rregullatore të vendosur nga autoriteti rregullator;
  - c) çdo kosto shtesë për mirëmbajtjen dhe përshtatjen, që rezulton nga ofrimi i aksesit në infrastrukturën fizike përkatëse;
  - ç) ndikimin e aksesit të kërkuar në planin e biznesit të ofruesit të aksesit, duke përfshirë investimet në infrastrukturën fizike për të cilën është kërkuar aksesit;
  - d) në rastin specifik të aksesit në infrastrukturën fizike të operatorëve, çdo udhëzim përkatës nga autoriteti rregullator në përputhje me praktikën e BEREC, në veçanti mbi:
    - i) qëndrueshmërinë ekonomike të këtyre investimeve bazuar në profilin e tyre të rrezikut;
    - ii) nevojën për një kthim të drejtë të investimit dhe për afatin kohor për një kthim të drejtë të investimit;
    - iii) çdo ndikim të aksesit në konkurrencën në rrjedhën e poshtme "*downstream*" dhe rrjedhimisht në çmimet dhe kthimin e investimit;
    - iv) çdo zhvlerësim të aseteve të rrjetit në kohën e kërkesës për akses;
    - v) çdo rast biznesi që mbështet investimin në kohën kur është bërë, në veçanti investimi në infrastrukturën fizike të përdorur për ofrimin e lidhjes; dhe

- vi) çdo mundësi të mëparshme, e ofruar kërkuarit të aksesit, për bashkëinvestim ose bashkëpërdorim në vendosjen e infrastrukturës fizike, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 54/2024 për komunikimet elektronike;
- e) nevojën për një kthim të drejtë të investimit që pasqyron kushtet përkatëse të tregut, dhe modelet e ndryshme të biznesit të operatorit, veçanërisht në rastin e sipërmarrësve që ofrojnë kryesisht facilitete shoqëruese dhe akses fizik për më shumë se një operator.
3. Në çdo rast, ushtrimi i të drejtës për akses në infrastrukturën fizike, me qëllim ndërtimin apo vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN), nuk e çënon të drejtën e pronësisë së pronarit të infrastrukturës fizike kur operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik nuk është pronar dhe të drejtën e pronësisë së çdo pale të tretë, siç janë pronarët e tokës dhe pronarët privatë të pronave, ose të drejtat e qiramarrësve, kur është e aplikueshme.

## Neni 7

### Refuzimi i aksesit në infrastrukturën fizike

1. Operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik, që kanë në pronësi ose kontrollojnë infrastrukturë fizike, mund të refuzojnë aksesin për një ose më shumë shkaqe si më poshtë:
- a) infrastruktura fizike nuk është teknikisht e përshtatshme për të hostuar ndonjë prej elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta (VHCN);
  - b) nuk ka hapësirë të lirë për të hostuar elemente të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë, ose facilitetet shoqëruese të tyre, duke përfshirë nevojat për hapësira për zhvillime në të ardhmen të vetë operatorit të rrjetit, të cilat duhet të argumentohen nga operatori i rrjetit;
  - c) ekzistojnë arsye të justifikuara për sigurinë dhe çështjet e shëndetit publik;
  - ç) ekzistojnë arsye të justifikuara për integritetin dhe sigurinë e çdo rrjeti, në veçanti sigurinë e infrastrukturës kritike kombëtare;
  - d) ka rrezik nga interferenca të dëmshme të shërbimeve të komunikimeve elektronike të planifikuara, me ato të shërbimeve të tjera të parashikuara mbi të njëjtën infrastrukturë fizike;
  - e) disponueshmëri e mjeteve alternative të zbatueshme të aksesit në infrastrukturën fizike të rrjetit në nivel shumice, të ofruar nga operatori i rrjetit, dhe të përshtatshme për ofrimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta (VHCN), me kusht që ky akses të jetë ofruar në kushte të drejta dhe terma të arsyeshme, nga i njëjti operator rrjeti, ose në rastet specifike në zonat rurale dhe të largëta, kur një rrjet operohet mbi bazën e ofrimit vetëm në nivel shumice dhe është në pronësi apo kontrollohet nga organet e sektorit publik, që janë ofruar nga operatori i këtij rrjeti;
  - f) cënimi i interesave ekonomike dhe të parimeve të konkurrencës së ndershme të operatorit të rrjetit.
2. Në rast refuzimi të aksesit, operatori i rrjetit ose organet e sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturën fizike sipas rastit, informon me shkrim kërkuarin e aksesit mbi arsyet specifike të refuzimit jo më vonë se një muaj nga marrja e kërkesës së plotësuar për akses. Në rastin e refuzimit të aksesit në infrastrukturën kritike, të përcaktuara si të tilla sipas legjislacionit në fuqi, operatori i rrjetit apo organi i sektorit publik nuk është i detyruar të japë arsye të detajuara për refuzimin e kërkesës.

## Neni 8

## Zbatimi i koordinuar i kërkesave për akses

1. Për të koordinuar kërkesat për akses në infrastrukturën fizike në pronësi, ose të kontrolluar nga organet e sektorit publik dhe me kërkesë të një operatori kërkuar të aksesit, AKEP bashkëpunon me ministrin përgjegjës.
2. Autoriteti rregullator në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse, marrin masa për të lehtësuar ofrimin e informacionit për kushtet e ofrimit të aksesit në infrastrukturat fizike ekzistuese, përmes një pike të vetme të informacionit.
3. Infrastruktura fizike, e cila i nënshtrohet detyrimeve të aksesit të vendosura nga AKEP, sipas ligjit nr. 54/2024, "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë", ose që rezultojnë nga zbatimi i rregullave të ndihmës shtetërore sipas legjislacionit në fuqi, nuk u nënshtrohet detyrimeve të përcaktuara në nenet 4, 6 dhe 7, të këtij ligji, për atë kohë sa këto detyrime për akses janë në fuqi.
4. Organet e sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturën fizike, ose kategori të caktuara të infrastrukturës fizike, mund të mos zbatojnë nenet 4, 6 dhe 7, të këtij ligji, për infrastrukturën fizike ose kategori të infrastrukturës fizike për arsye të vlerës arkitektonike, historike, fetare ose mjedisore, ose për arsye të sigurisë publike, mbrojtjes, sigurisë kombëtare dhe shëndetit.
5. Autoritetet përgjegjëse të sektorit publik në nivel qendror dhe vendor, identifikojnë infrastrukturën fizike ose kategoritë e infrastrukturës fizike sipas pikës 4, të këtij neni, në territoret e tyre, bazuar në arsye të justifikuar dhe proporcionale. Lista e kategorive të infrastrukturës fizike dhe kriteret e zbatuar për identifikimin e tyre, vihen në dispozicion të kërkueseve nëpërmjet një pike të vetme informacioni.
6. Ministri në bashkëpunim me AKEP dhe autoritetet e tjera përgjegjëse, nxjerr udhëzime për zbatimin e këtij neni, në përputhje me praktikën e BE-së dhe udhëzimet e BEREC.

## KREU III

### GARANTIMI I TRANSPARENCËS PËR INFRASTRUKTURËN FIZIKE

#### Neni 9

#### Detyrimi për informacionin minimal për infrastrukturën fizike

1. Çdo operator i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike të kapaciteteve të larta, me qëllim aksesin në infrastrukturën fizike të një rrjeti ekzistues, sipas këtij ligji, ka të drejtën e aksesit në informacionin minimal për infrastrukturën fizike ekzistuese të një operatori rrjeti, kundrejt kërkesës.
2. Informacioni minimal për infrastrukturën fizike duhet të përmbajë, të paktën, të dhënat për:
  - a) vendndodhjen dhe rrugëzimin e rrjetit, nëse ka infrastrukturë fizike në këtë zonë dhe cilat janë pikat fundore të saj;
  - b) llojin dhe përdorimin aktual të infrastrukturës;
  - c) një pikë kontakti të operatorit të rrjetit.
3. Informacioni minimal sipas pikës 2, të këtij neni, bëhet i aksesueshëm në kushte proporcionale, jo diskriminuese dhe transparente dhe në çdo rast jo më vonë se dhjetë ditë pune nga marrja e kërkesës për akses në informacion. Në rastet e justifikuar, ky afat mund të zgjatet me pesë ditë pune. Operatorët kërkuar informohen për zgjatjen e afatit përmes pikes së vetme të informacionit.

4. Kërkesa për informim, sipas pikës 1, të këtij neni, duhet të specifikojë zonën në të cilën do të zhvillohen elementet e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta. Kërkesa për informacionin minimal mund të përfshijë dhe informacion për zhvillimet e pritshme apo punimet civile të parashikuara për zhvillimin e rrjetit ekzistues.
5. Dhënia e aksesit në informacionin minimal mund të kufizohet vetëm nëse është e nevojshme, me qëllim sigurinë e rrjeteve dhe integritetin e tyre, sigurinë kombëtare, sigurinë e shëndetit publik, konfidencialitetin ose sekretin tregtar, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi.
6. Përveç informacionit minimal të përmendur në pikën 2, të këtij neni, operatorët e rrjetit mund të kërkojnë informacion mbi infrastrukturën fizike ekzistuese, siç është informacioni mbi nivelin e përdorimit së infrastrukturës fizike.
7. Operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik vënë në dispozicion të paktën informacionin minimal të përmendur në pikën 2, të këtij neni dhe, kur është e aplikueshme, informacionin shtesë të përmendur në pikën 6, të këtij neni nëpërmjet një pike të vetme informacioni dhe në format elektronik. Çdo përditësim i këtij informacioni, i vihet në dispozicion operatorit kërkuar pa vonesë.
8. Në rast se operatorët e rrjetit ose organet e sektorit publik, nuk përmbushin kërkesat sipas pikës 2, të këtij neni, autoriteti rregullator i kërkon subjektit në fjalë, vënien në dispozicion të informacionit në format elektronik nëpërmjet pikes së vetme të informacionit, brenda 10 ditëve pune nga data e marrjes së kërkesës së autoritetit rregullator.

#### **Neni 10** **Verifikimi në vend**

1. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, pas marrjes së përgjigjes pozitive nga operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik, sipas pikës 3, të nenit 5, të këtij ligji, ka të drejtë të paraqesë kërkesën me shkrim tek operatori i rrjetit, ose sipas rastit tek organi i sektorit publik, për një verifikim në vend të elementeve specifike të infrastrukturës së tij fizike.
2. Operatorët e rrjetit dhe organet e sektorit publik, përmbushin kërkesa të arsyeshme për studimin në vend të elementëve specifike të infrastrukturës së tyre fizike, me kërkesë specifike me shkrim të një operatori.
3. Kërkesa me shkrim duhet të specifikojë elementet e infrastrukturës fizike në fjalë, me qëllim vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), ose facilitetet shoqëruese. Plotësimi i kërkesës për verifikim në vend dhe të elementeve të specifikuara të infrastrukturës fizike, kryhet në respektim të parimeve të proporcionalitetit, në kushte jodiskriminuese dhe transparente, jo më vonë se 1 muaj nga data e marrjes së kërkesës me shkrim, në varësi të kufizimeve të përcaktuara në pikën 5, të nenit 9, të këtij ligji.
4. Parashikimet e nenit 9, të këtij ligji në lidhje me informacionin minimal sipas pikës 2, dhe pikës 7, të nenit 9 të këtij ligji, si dhe pikës 2, të këtij neni, nuk aplikohen në rastet kur:
  - a) infrastruktura fizike nuk është teknikisht e përshtatshme për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), ose faciliteteve shoqëruese;
  - b) detyrimi për të ofruar informacion në lidhje me lloje të caktuara ekzistuese të infrastrukturës fizike sipas paragrafit 1, nënparagrafi i parë, do të ishte joproporcional, në bazë të një analize kosto-përfitim të kryer nga autoriteti rregullator dhe një konsultimi me palët e interesuara; ose
  - c) infrastruktura fizike nuk u nënshtrohet detyrimeve të aksesit në përputhje me pikën 4, të nenit 8 të këtij ligji.

Arsyet kriteret dhe kushtet për zbatimin e çdo përjashtimi sipas kësaj pike, publikohen nëpërmjet një pike të vetme të informacionit.

5. Operatorët që përfitojnë akses në informacion, sipas këtij neni, janë të detyruar të ruajnë konfidencialitetin dhe sekretin tregtar dhe marrin masat e duhura për të siguruar respektimin e konfidencialitetit, si dhe sekreteve të funksionimit operacional dhe të biznesit. Informacioni i marrë për këtë qëllim, përdoret vetëm për qëllimin e vendosjes së rrjeteve të tyre.
6. Shpenzimet që lidhen me procesin e verifikimit në vend, si kosto transporti, kosto e punonjësve të angazhuar për verifikimin në vend, mbulohen nga pala kërkuese.

## **KREU IV**

### **KOORDINIMI I PUNIMEVE CIVILE**

#### **Neni 11**

##### **Koordinimi i punimeve civile**

1. Organet e sektorit publik që zotërojnë ose kontrollojnë infrastrukturë fizike dhe operatorët e rrjetit, kanë të drejtë të negociojnë dhe lidhin marrëveshje për koordinimin e punimeve civile, përfshirë kostot proporcionale, me sipërmarrësit e rrjeteve të komunikimeve elektronike, me qëllim zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN) ose facilitetet shoqëruese.
2. Çdo organ i sektorit publik që zotëron ose kontrollon infrastrukturë fizike dhe operatorët e rrjetit, që kryejnë apo planifikojnë të kryejnë vetë apo me palë të treta punime civile, të financuara totalisht apo pjesërisht me fonde publike, duhet të plotësojë çdo kërkesë të arsyeshme me shkrim, sipas nenit 12, të këtij ligji, për koordinim të punimeve civile, me kushte transparente dhe jodiskriminuese, të bërë nga operatorët, me qëllim zhvillimin e elementëve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN).

#### **Neni 12**

##### **Kërkesa për koordinimin e punimeve civile**

1. Kërkesa për koordinimin e punimeve civile, sipas nenit 11, të këtij ligji, konsiderohet e arsyeshme kur plotëson këto kushte:
  - a) nuk sjell kosto shtesë apo vonesa për fillimin e punimeve civile dhe nuk rrezikon kryerjen e punimeve sipas afateve të lejes së ndërtimit, për operatorin e rrjetit ose organin e sektorit publik që zotëron apo kontrollon infrastrukturë fizike nga kostot fillestare për punimet civile në fjalë pa cënuar mundësinë e palëve të interesuara për të dakordësuar për ndarjen e kostove;
  - b) nuk pengon mbikëqyrjen e punimeve civile të koordinuara nga operatori i rrjetit apo organi i sektorit publik që ka filluar punimet civile;
  - c) kërkesa për koordinim bëhet sa më shpejt të jetë e mundur, por në çdo rast, jo më vonë se një muaj nga paraqitja e projektit final pranë autoritetit planifikues kompetent, për dhënien e lejes së ndërtimit;
  - ç) nuk cënon objektivat dhe funksionalitetin e investimit të operatorit të rrjetit;
  - d) nuk cënon integritetin dhe sigurinë e rrjetit dhe është në përputhje me parashikimet e legjislacionit që rregullon fushën e veprimtarisë së operatorit të rrjetit.

2. Kërkesa për koordinimin e punimeve civile, duhet të dorëzohet sa më shpejt të jetë e mundur, me marrjen e informacionit për fillimin e punimeve civile nga një operator rrjeti, por, në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë përpara dorëzimit të projektit final tek autoriteti planifikues kompetent për dhënien e lejes për punime civile, sipas ligjit për planifikimin dhe zhvillimin e territorit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.
3. Në rast se marrëveshja për koordinimin e punimeve civile, sipas pikës 1, të nenit 11, nuk arrihet brenda 15 ditëve nga data e marrjes së kërkesës formale për të negociuar, çdo palë ka të drejtë t'i drejtohet autoritetit përgjegjës, sipas parashikimeve në nenin 40, të këtij ligji.
4. Autoriteti përgjegjës në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, sipas pikës 3, të këtij neni, bazohet në parimin e proporcionalitetit dhe vendos për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, duke përcaktuar kushte të drejta dhe jodiskriminuese.
5. Autoriteti përgjegjës duhet të trajtojë kërkesën, referuar pikës 3, të këtij neni, brenda një afati kohor shumë të shkurtër dhe në çdo rast, jo më vonë se 30 ditë nga data e marrjes së kërkesës së plotë. Palët në proces kanë të drejtën që ta adresojnë çështjen në gjykatë, në rast të mospërgjegjës nga ana e autoritetit përgjegjës dhe kanë të drejtë të ankimojnë në gjykatë çdo vendim të autoritetit përgjegjës, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjeve të posaçme.
6. Detyrimet e parashikuara në këtë nen, nuk aplikohen për punimet civile që nuk janë të një rëndësie të veçantë, bazuar në vlerën, sasinë dhe kohëzgjatjen e punimeve, ose në rastet e punimeve për infrastrukturën kombëtare kritike, si dhe në rastet e kërkesave të paarsyeshme sipas nenit 13, të këtij ligji. Refuzimi i koordinimit të punimeve civile, në këto raste, duhet të arsyetohet, duke u dhënë palëve të interesuara mundësinë e shprehjes së mendimit brenda një periudhe të arsyeshme kohore, por jo më pak se 15 ditë.
7. Nëse një kërkesë për koordinim konsiderohet e paarsyeshme sipas përcaktimeve të nenit 13, të këtij ligji, sipërmarrësi që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike dhe që i kanë refuzuar koordinimin e punimeve civile, vendos infrastrukturë fizike me kapacitet të mjaftueshëm për të akomoduar nevojat e arsyeshme të mundshme në të ardhmen, për akses të palëve të treta.
8. Rregullat për shpërndarjen e kostove, të lidhura me koordinimin e punimeve civile, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, sipas llojit dhe kategorisë së punimeve, në përputhje me parimet e transparencës, proporcionalitetit dhe orientimit në kosto.
9. Kriteret për sigurimin e kapacitetit të mjaftueshëm për të përballuar nevojat e arsyeshme të parashikueshme në të ardhmen, nëse koordinimi i punimeve civile refuzohet në përputhje me pikën 7, të këtij neni, miratohen me rregullore të AKEP, në përputhje me praktikën e BE dhe udhëzimet e BEREC.

### **Neni 13**

#### **Kërkesat e paarsyeshme**

1. Kërkesa për koordinimin e punimeve civile e paraqitur nga një sipërmarrës që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike tek një sipërmarrës në pronësi, ose i kontrolluar nga një organ i sektorit publik që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike, mund të konsiderohet e paarsyeshme kur punimet civile lidhen me vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), në zona rurale ose të largëta dhe që janë në pronësi ose të kontrolluara nga organet e sektorit publik dhe operohen vetëm me shumicë.

2. Një kërkesë për koordinimin e punimeve civile e paraqitur nga një sipërmarrës që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike tek një sipërmarrës në pronësi, ose i kontrolluar nga një organ i sektorit publik që ofron, ose është autorizuar të ofrojë, rrjete publike të komunikimeve elektronike, mund të konsiderohet e paarsyeshme kur plotësohen njëkohësisht dy kushtet e mëposhtme:
  - a) kërkesa ka të bëjë me një zonë ku:
    - i. ka parashikime për shtrirjen e rrjeteve me brez të gjerë, përfshirë rrjete të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), sipas përcaktimeve në pikën 1, të nenit 43, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”
    - ii. është deklaruar planifikim për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN) sipas përcaktimeve në pikën 6, të nenit 43, të ligjit nr. 54/2024 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ose,
    - iii. ka një proces konsultimi publik për zbatimin e ndihmës shtetërore në zonë.
  - b) sipërmarrësi kërkues nuk arrin të shprehë qëllimin e tij për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), në zonën e përmendur në pikën a), në asnjërin nga procedurat më të fundit të përmendura në pikën a), dhe që përfshin periudhën gjatë të cilës bëhet kërkesa për koordinim.

#### Neni 14

#### Transparenca e punimeve civile të planifikuara

1. Me qëllim koordinimin e punimeve civile, sipas nenit 11, të këtij ligji, çdo operator i rrjetit dhe organ i sektorit publik që zotëron ose kontrollon infrastrukturë fizike, bën të disponueshëm, kundrejt kërkesës me shkrim të një sipërmarrësi të rrjeteve të komunikimeve elektronike publike të shpejtësisë së lartë, informacionin minimal lidhur me punimet civile të planifikuara ose në proces, kur ato lidhen me infrastrukturën e tij fizike, për të cilën është dhënë leja, kur procedura për dhënien e lejes është pezull, ose kur aplikimi pranë autoriteteve kompetente për dhënien e lejeve do të bëhet brenda 6 muajve.
2. Informacioni minimal duhet të përmbajë:
  - a) vendndodhjen dhe llojin e punimeve;
  - b) elementet e infrastrukturës fizike të përfshirë;
  - c) datën e parashikuar për fillimet e punimeve dhe kohëzgjatjen e tyre;
  - ç) datën e parashikuar për paraqitjen e projektit final tek autoriteti kompetent për dhënien e lejes kur është rasti;
  - d) pikën e kontaktit.
3. Operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik që zotëron ose kontrollon infrastrukturën fizike në fjalë, siguron që ky informacion është korrekt dhe i përditësuar rregullisht përmes pikës së vetme të informacionit, sapo informacioni është i disponueshëm për operatorin e rrjetit për punimet e tij civile në gjashtë muajt e ardhshëm dhe në çdo rast dhe kur parashikohet një leje, jo më vonë se dy muaj para paraqitjes së parë të kërkesës për leje pranë autoritetit kompetent të planifikimit.
4. Kërkesa e një sipërmarrësi të rrjeteve të komunikimeve publike të shpejtësisë së lartë (VHCN) duhet të specifikojë zonën, në të cilën do të zhvillohen elementet e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë (VHCN). Informacioni për elementet e rrjetit, kufizohet në të dhënat e nevojshme, për qëllim të koordinimit të punimeve civile, pa cënuar konfidencialitetin dhe sekretin tregtar të operatorit të rrjetit. Brenda 10 ditëve pune, nga data e marrjes së kërkesës me shkrim,

informacioni sipas pikës 2, të këtij neni i vihet në dispozicion operatorit kërkues, në kushte proporcionale, jodiskriminuese, transparente dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në raste të justifikuara, afati për dhënien e informacionit mund të shtyhet dhe me pesë ditë pune.

5. Aksesit në informacionin minimal, mund të kufizohet për projektet e zhvillimit të rrjetit, apo për punimet civile të lidhura me to, vetëm në rastet kur është e nevojshme për sigurinë dhe integritetin e rrjetit, sigurinë kombëtare, sigurinë e shëndetit publik, konfidencialitetin dhe sekretin tregtar.

## **Neni 15**

### **Ndërtimi i infrastrukturës publike**

1. Çdo organ shtetëror ose ent publik, që parashikon të kryejë punime ndërtimi ose gërmimi në infrastrukturën e transportit publik, 90 ditë përpara datës së planifikuar për fillimin e punimeve, bën publike projektet, në përputhje me legjislacionin në fuqi për të drejtën e informimit, nëpërmjet faqes zyrtare të internetit dhe pikës së vetme të informacionit, në Sistemin e Përqendruar të Informacionit, duke specifikuar afatin, brenda të cilit sipërmarrësit e interesuar mund të paraqesin kërkesë për të përfutur të drejtën e kalimit në këtë sipërfaqe ose për koordinimin e punimeve civile, me qëllim:

- a) ndërtimin e tubacioneve kabllore;
- b) aksesin në tubacionet kabllore ekzistuese;
- c) shtrirjen e linjave të komunikimeve elektronike.

2. Nëse sipërmarrësi paraqet kërkesë për dhënien e të drejtës së kalimit brenda afatit të njoftuar, sipas pikës 1, të këtij neni, atëherë zbatohen rregullat e këtij ligji për të drejtën e kalimit në pronën e shtetit.

3. Në çdo rast, planifikimet e ndërtimeve të reja në infrastrukturën e transportit publik, duhet të shoqërohen me parashikime për ndërtimin e tubacioneve kabllore për rrjetet e komunikimit elektronik. Përfshirja e parashikimeve të hapësirave të nevojshme për ndërtimin e tubacioneve kabllore në ndërtimin e infrastrukturës së transportit publik, u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të ligjit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

4. Organet kompetente, për miratimin e lejeve të punimeve, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, sigurojnë përmbushjen e detyrimit të përcaktuar në këtë nen, duke bashkëpunuar, kur çmohet e nevojshme, me autoritetin përgjegjës.

4. Organet kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, i përcjellin autoritetit përgjegjës informacion në lidhje me parashikimet e hapësirave të nevojshme për ndërtimin e tubacioneve kabllore, si dhe për ekzistencën e këtyre hapësirave, kur punimet kanë përfunduar, me qëllim publikimin e informacionit në pikën e vetme të informacionit.

5. Mungesa e parashikimeve për hapësirat e nevojshme për ndërtimin e tubacioneve kabllore në ndërtimin e infrastrukturës së transportit publik, sipas pikës 4, të këtij neni, përbën shkak për mosfillimin e punimeve.

## **KREU V**

### **PROCEDURA E DHËNIES SË LEJEVE PËR PUNIME**

## **Neni 16**

### **Dhënia e lejeve**

1. Autoritetet e planifikimit, kompetente për dhënien e lejeve nuk kufizojnë ose pengojnë

- padrejtësisht, vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN) ose faciliteteve shoqëruese të tyre.
2. Informacioni në lidhje me kushtet dhe procedurat e aplikueshme për dhënien e lejeve për punimet civile, të nevojshme për zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitete të larta (VHCN), ofrohet nëpërmjet sistemit elektronik nga autoritetet kompetente të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi për zhvillimin dhe planifikimin e territorit.
  3. Informacioni sipas pikës 2, të këtij neni, përfshin listën e autoriteteve kompetente sipas procedurës përkatëse, rregullat specifike të aplikuara sipas procedurave për dhënien e lejeve dhe krijimin e të drejtës së kalimit, informacionin që kërkohet me aplikimin për leje, afatet për dhënien e lejes, mjetet e ankimimit, çdo tarifë të aplikueshme, si dhe rastet e përjashtimit nga detyrimi për marrjen e lejes në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
  4. Procedurat për aplikimin dhe miratimin e lejeve për kryerjen e punimeve civile, të cilat janë të nevojshme për zhvillimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike përfshirë ato me kapacitet të lartë, përcaktohen në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.
  5. Autoritetet e planifikimit, publikojnë çdo rregull që rregullon kushtet dhe procedurat e zbatueshme për dhënien e lejeve dhe të drejtave të kalimit, të kërkuara për vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), ose facilitetet shoqëruese.
  6. Ndërtimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, duhet të kryhet duke respektuar rregullat për kushtet teknike dhe standardet për rrjetet e komunikimeve elektronike të miratuara nga AKEP.
  7. Autoritetet e planifikimit, kompetente për dhënien e lejeve, japin ose refuzojnë lejet brenda afateve kohore, në përputhje me legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, në çdo rast jo më vonë se katër muaj nga paraqitja e aplikimit të plotësuar.
  8. Autoritetet kompetente mund të refuzojnë kërkesat për leje, brenda 15 ditëve pune nga marrja e saj, kur informacioni minimal i kërkuar për lejen nuk është vënë në dispozicion.
  9. Brenda 20 ditëve pune nga marrja e kërkesës, autoritetet e planifikimit kompetente për dhënien e lejeve, njoftojnë aplikantin mbi plotësimin e kërkesës për leje dhe sipas rastit dhe për të drejtën e kalimit, duke i kërkuar të paraqesë çdo informacion që mungon brenda asaj periudhe.
  10. Çdo refuzim i kërkesës për lejet duhet të arsyetohet, bazuar në kriteret e transparencës, objektivitetit, mosdiskriminimit dhe proporcionalitetit.
  11. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, i cili ka pësuar dëme, si pasojë e mosrespektimit të afateve të zbatueshme, sipas këtij neni, ka të drejtë të kërkojë kompensim për dëmin e shkaktuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
  12. Sipërmarrësi i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike, të cilit i është refuzuar aplikimi për leje, ka të drejtë të ankimojë vendimin e autoritetit planifikues kompetent në gjykatë.

#### Neni 17

#### Përjashtimi nga procedurat për leje ndërtimi

1. Punimet civile të mëposhtme, për rrjetet e komunikimeve elektronike, nuk u nënshtrohen procedurave për leje ndërtimi sipas kuptimit të nenit 18, të këtij ligji, përveçse kur legjislacioni në fuqi për fushën e ndërtimit përcakton ndryshe:
  - a) punimet e riparimit dhe mirëmbajtjes së elementeve ose të rrjeteve të komunikimit elektronik të kufizuara në natyrë/scope dhe në termat e vlerës, madhësisë, ndikimit dhe kohëzgjatjes;

- b) punimet për përditësimin/*upgrade* të sistemeve teknike ose të instalimeve ekzistuese me ndikim të kufizuar;
- c) punime civile për ndërhyrje të vogla që janë të kufizuara në natyrë/*scope*, në termat e vlerës, madhësisë, ndikimit dhe kohëzgjatjes për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN).
2. Llojet e punimeve civile për të cilat zbatohet pika 1, e këtij neni, përcaktohen me udhëzim të ministrit përgjegjës, në konsultim me autoritetet kompetente të planifikimit dhe AKEP. Informacioni mbi llojet e punimeve civile që i nënshtrohen pikës 1, publikohet nëpërmjet pikës së vetme të informacionit.
3. Pavarësisht nga përcaktimet e pikës 1 dhe 2, të këtij neni, autoritetet kompetente të planifikimit, mund të kërkojnë leje për vendosjen e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), ose faciliteteve shoqëruese në rastet e mëposhtme:
- a) për infrastrukturën fizike ose kategori të çaktuara të infrastrukturës fizike në zona të mbrojtura, për arsye vlerash arkitekturore, historike, fetare ose mjedisore, ose të mbrojtura në përputhje me legjislacionin në fuqi; ose
- b) kur është e nevojshme për arsye sigurie publike, mbrojtjeje, sigurie, mjedisore ose të shëndetit publik, ose për të mbrojtur sigurinë e infrastrukturës kritike.
4. Operatorët që planifikojnë kryerjen e punimeve civile, sipas këtij neni, para fillimit të punimeve njoftojnë autoritetet kompetente mbi qëllimin e tyre për të filluar punimet civile.
5. Njoftimi sipas pikës 4, të këtij neni, përfshin një deklaratë të operatorit, si dhe një informacion minimal të nevojshëm për vlerësimin nga autoritetet kompetente, nëse këto punime bëjnë pjesë në rastet e përjashtuara sipas këtij neni. Informacioni minimal përfshin të paktën datën kur pritet të fillojnë punimet civile, kohëzgjatjen e tyre, të dhënat e kontaktit të personit përgjegjës për kryerjen e punimeve, si dhe zonën e prekur nga punimet.

## KREU VI TË DREJTAT E PRONËSISË

### Neni 18

#### Të drejtat e pronësisë të sipërmarrësve të komunikimeve elektronike

1. Për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN) sipërmarrësit mund të ushtrojnë një ose disa nga këto të drejta mbi pronën publike ose private:
- a) të drejtën e kalimit;
- b) të drejtën e përdorimit të përkohshëm;
- c) të drejtën e shpronësimit, sipas legjislacionit për shpronësimet.
2. Në zonat natyrore të mbrojtura, të drejtat e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, jepen me miratimin paraprak të autoritetit përgjegjës për mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për zonat e mbrojtura. Për zonat që janë në administrim të njësisive të qeverisjes vendore, nevojitet miratimi paraprak i njësisë përkatëse vendore.
3. Kur ushtrohen të drejtat, sipas pikës 1, të këtij neni, dëmet e shkaktuara pronarit ose përdoruesit të pronës shërbyese i rimbursohen nga sipërmarrësi, në përputhje me Kodin Civil dhe legjislacionin për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.
4. Në rastin e përfundimit të të drejtave të përcaktuara në pikën 1, të këtij neni, sipërmarrësi është i detyruar të kthejë pronën e përdorur në gjendjen e mëparshme.

### Neni 19

## **E drejta e kalimit**

1. E drejta e kalimit për ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike mbi pronën e të tretëve, u jepet sipërmarrësve të komunikimeve elektronike bazuar në dispozitat e Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacionit në fuqi, duke garantuar përdorimin e pronës, në përputhje me standardet dhe rregullat e shfrytëzimit dhe të sigurimit teknik të rrjeteve të komunikimeve elektronike.

2. Në përputhje me të drejtën e kalimit, sipërmarrësi që ofron, ose është i autorizuar të ofrojë rrjete të komunikimeve publike, mund të kryejë, në pronën e të tretit, këto veprime:

a) të instalojë dhe të mbajë rrjetin e komunikimeve elektronike mbi tokë, nën tokë, mbi ujë apo nën ujë;

b) të ndërtojë dhe të mbajë struktura mbështetëse të linjave, pajisje ndërtuese dhe objekte të tjera të linjës, si dhe aksesore shtesë;

c) të vendosë linja kabllore në ndërtesa dhe struktura të tjera;

ç) të vërë në punë sistemet e listuara në shkronjat "a", "b" e "c", të kësaj pike;

d) të heqë pemët, shkurret, degët e tyre dhe rrënjët e ndodhura brenda zonës së sigurisë së rrjeteve të komunikimeve elektronike, të cilat çenojnë sigurinë e funksionimit të tyre, duke respektuar dispozitat e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e mjedisit.

3. Në rast se sipërmarrësi është pajisur me instrumentet e veçanta të lejeve dhe të kontrollit të zhvillimit, në përputhje me ligjin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, si dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, atëherë e drejta e kalimit do të prezumohet e dhënë me këto instrumente dhe nuk do të aplikohet për leje kalimi të veçantë.

4. Procedurat për sigurimin e së drejtës së kalimit nuk aplikohen në rastet kur ajo çënon:

a) sigurinë dhe integritetin e rrjetit dhe të pronës;

b) sigurinë kombëtare;

c) sigurinë e shëndetit publik.

## **Neni 20**

### **E drejta e përdorimit të përkohshëm**

1. Rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe strukturat mbështetëse të tyre, mund të ndërtohen apo vendosen, të funksionojnë dhe të mirëmbahen, në pronën e të tretëve, në bazë të së drejtës së përdorimit të përkohshëm, sipas dispozitave të legjislacionit specifik në fuqi.

2. E drejta e përdorimit të përkohshëm, rregullohet sipas legjislacionit për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik.

3. E drejta e përdorimit të përkohshëm nuk aplikohet në rastet kur ajo çënon:

a) sigurinë dhe integritetin e rrjetit dhe pronës;

b) sigurinë kombëtare;

c) sigurinë e shëndetit publik.

## **Neni 21**

### **Rastet e kërkesës për shpronësim**

1. Përveç sa parashikon ligji për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private për interes publik, kërkesa për shpronësim, me qëllim ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë (VHCN) në prona private, mund të bëhet nga sipërmarrësi vetëm në raste të domosdoshme, për projekte madhore dhe kur ndërtimi i rrjetit, për interes publik, nuk ka mundësi tjetër zhvillimi.

2. Nisja e procedurës së shpronësimit, me qëllim ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë (VHCN), mund të kërkohej vetëm nëse e drejta e kalimit, sipas nenit 21, të këtij ligji, pengon ose ndërpret, në mënyrë thelbësore, përdorimin e rregullt të pronës.

## **KREU VII SIGURIMI I SË DREJTËS SË KALIMIT**

### **Seksioni 1**

#### **E drejta e kalimit në prona të shtetit Qeverisja vendore**

##### **Neni 22**

#### **Kompetencat e organeve të qeverisjes vendore**

1. Bashkia është përgjegjëse për:

- a) shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimeve për pranimin ose refuzimin e dhënies së të drejtës së kalimit, kur rrjeti i komunikimeve elektronike shtrihet në prona të bashkisë;
- b) mbikëqyrjen e ushtrimit të së drejtës së kalimit;
- c) çdo çështje tjetër që lidhet me ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të komunikimeve elektronike në kompetencë të tyre, sipas legjislacionit në fuqi.

2. Bashkitë ushtrojnë veprimtarinë e tyre si autoritet kompetent, për miratimin e së drejtës së kalimit dhe lejeve të ndërtimit, në përputhje me këtë ligj, aktet nënligjore të dala në bazë dhe në zbatim të këtij ligji, legjislacionit në fuqi për organet e vetëqeverisjes vendore dhe të planifikimit dhe zhvillimit të territorit.

3. Në ushtrimin e veprimtarisë së tyre për dhënien e së drejtës së kalimit dhe/ose lejes së ndërtimit, bashkitë udhëhiqen nga parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit.

4. Rregullat e përgjithshme për procedurat e dhënies së të drejtës së kalimit, miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.

##### **Neni 23**

#### **Veprimet paraprake të shqyrtimit të kërkesës**

1. Kërkesa për të drejtë kalimi, e shoqëruar me dokumentacionin përkatës, depozitohet *online* ose pranë sportelit të shërbimit me një ndalesë, të ngritur pranë çdo njësie bazë të qeverisjes vendore, sipas parashikimeve të përcaktuara në legjislacionin për planifikimin dhe zhvillimin e territorit.

2. Autoriteti përgjegjës për shqyrtimin e kërkesës, brenda 5 ditëve nga paraqitja e saj, verifikon nëse dokumentacioni është i plotë dhe njofton aplikuesin, në rast se aplikimi nuk është i plotë.

##### **Neni 24**

#### **Vendimi për miratimin e së drejtës së kalimit**

1. Vendimi për miratimin e së drejtës së kalimit, i cili duhet të jetë i arsyetuar, merret nga autoriteti përgjegjës, sipas kushteve dhe afateve të parashikuara në legjislacionin për organet e vetëqeverisjes vendore.

2. Në rast refuzimi të miratimit të së drejtës së kalimit, vendimi duhet të jetë i arsyetuar.

3. Kundër vendimit për refuzimin e së drejtës së kalimit, aplikuesi ka të drejtë të ankohet pranë gjykatës administrative kompetente, në territorin e njësisë vendore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.

## Neni 25

### Miratimi i heshtur i së drejtës së kalimit

Nëse miratimi i së drejtës së kalimit, nuk është dhënë brenda afatit të parashikuar në nenin 24, të këtij ligji, miratimi konsiderohet i pranuar në heshtje, sipas parashikimeve në Kodin e Procedurave Administrative.

## Neni 26

### Lehtësimi i procedurave

1. Në rastin e aplikimit për ndërtimin e një rrjeti të ri, që shtrihet në pronën e vetëqeverisjes vendore, aplikimi për të drejtën e kalimit dhe për marrjen e lejes së ndërtimit të rrjetit apo të elementeve të tij do të konsiderohen njëherazi.
2. Bashkia publikon rregullat dhe procedurat për aplikimin e së drejtës së kalimit për rrjetet e komunikimeve elektronike, si dhe për lejet e ndërtimit.
3. Rregullat duhet të jenë objektive, transparente, jodiskriminuese, që garantojnë trajtimin e barabartë të sipërmarrësve dhe respektimin e parimeve të konkurrencës.

## Seksioni 2

### Qeverisja qendrore

## Neni 27

### Kërkesa për të drejtën e kalimit

1. Kërkesa për të drejtën e kalimit, paraqitet pranë entit pronar të rrugës, kur rrjeti do të shtrihet në rrugët shtetërore, apo pranë autoritetit përkatës, që përfaqëson pronarin e pronës shtetërore, kur rrjeti apo pjesë të tij vendosen në godina prona të shtetit, sipas rastit.
2. Autoriteti është organi përgjegjës për:
  - a) shqyrtimin e kërkesës dhe marrjen e vendimeve për pranimin ose refuzimin e dhënies së të drejtës së kalimit;
  - b) zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, në lidhje me të drejtat e kalimit, si dhe shuarjes së parakohshme të tyre;
  - c) mbikëqyrjen e ushtrimit të së drejtës së kalimit;
  - ç) zbatimin e kuadrit rregullator të vendosur nga ky ligj, të akteve nënligjore të dala në bazë ose në zbatim të tij dhe politikave të zhvillimit, të përcaktuara nga Këshilli i Ministrave, si dhe propozimin e legjislacionit që lidhet me to;
  - d) çdo çështje tjetër, sipas parashikimit të këtij ligji dhe legjislacionit në fuqi.
3. Me marrjen e kërkesës për të drejtën e kalimit, autoriteti ia kalon atë për shqyrtim strukturës përgjegjëse, e cila, brenda 5 ditëve, përgatit dosjen e plotë, me materialet që i bashkëlidhen kërkesës, përgatit një relacion shpjegues për kërkesën, si dhe për plotësimin e kriterëve ligjore për përfitimin e së drejtës së kalimit dhe ia përçjell ato titullarit të autoritetit.
4. Në ushtrimin e veprintarisë së tij, autoriteti udhëhiqet nga parimet e objektivitetit, transparencës dhe mosdiskriminimit. Autoriteti kthen përgjigje për miratimin apo refuzimin e kërkesës, jo më vonë se 20 ditë nga paraqitja e saj.
5. Në rast refuzimi të kërkesës, autoriteti duhet të japë një vendim të arsyetuar për shkaqet e refuzimit.
6. Për vendimin e autoritetit, sipërmarrësi ka të drejtë t'i drejtohet ministrit, për të ushtruar të drejtat e parashikuara në nenin 20 të këtij ligji.

Seksioni 3  
**E drejta e kalimit në pronë private**

**Neni 28**  
**Rregulla të përgjithshme**

1. Sipërmarrësi ka të drejtën të ushtrojë të drejtën e kalimit në pronë private, sipas legjislacionit në fuqi, me përjashtim të rasteve kur:
  - a) çënohet interesi publik;
  - b) përdorimi i pronës, sipas destinimit, nuk mund të realizohet, ose është lehtësisht i kufizuar në mënyrë të qëndrueshme nga një përdorim i tillë;
  - c) ekziston një e drejtë kalimi mbi pronën, e cila ushtrohet nga një sipërmarrës tjetër dhe përdorimi i përbashkët i pronës nuk është i mundur ose i praktikueshëm, apo sipërmarrësi, që është duke e ushtruar të drejtën e kalimit, nuk ka detyrimin për të lejuar përdorimin e përbashkët;
  - ç) nga ushtrimi i së drejtës së kalimit çënohen karakteristikat dhe vlerat unike të pronës.
2. E drejta e kalimit nga pronari i pronës shërbyese, duhet të ofrohet në kushte të barabarta, transparente dhe jodiskriminuese.
3. Nëse ekzistojnë rrjete të tjera të infrastrukturës në pronën shërbyese, sipërmarrësi duhet të garantojë mosçënimin e tyre. Çdo dëmtim, i shkaktuar nga ushtrimi i së drejtës së kalimit, zhdëmtohet nga sipërmarrësi apo operatori i rrjetit që e ka shkaktuar.

**Neni 29**  
**Fitimi i së drejtës së kalimit me marrëveshje**

1. E drejta e kalimit në pronë private, përfitohet në marrëveshje me pronarin e pronës.
2. Sipërmarrësi, i cili në ushtrim të së drejtës së kalimit, ka të drejtën të ndërtojë rrjetin e komunikimeve elektronike, duhet të njoftojë, me shkrim, pronarin e pronës, në lidhje me ndërtimet e planifikuara, si dhe të lidhë marrëveshje me të.
3. Në momentin e propozimit për të lidhur marrëveshjen, sipërmarrësi i njofton pronarit llojin e punimeve që do të kryhen, duke përfshirë edhe projektin për realizimin e këtyre punimeve.

**KREU VIII**  
**INFRASTRUKTURA E DETYRUESHME PËR RRJETET VHCN**

**Neni 30**  
**Infrastruktura e detyrueshme në ndërtimet e reja**

1. Ndërtimet e reja duhet të përmbajnë infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për shtrirjen e rrjetit të komunikimeve elektronike dhe lidhjen e rrjetit të brendshëm të komunikimeve elektronike me rrjetin e jashtëm, deri në vendndodhjen e përdoruesit fundor.
2. Të gjitha ndërtimet e reja dhe ndërtimet që i nënshtrohen rinovimeve të mëdha, përfshirë elementët me bashkëpronësi, për të cilat aplikimi për leje ndërtimi paraqitet pas datës **1 korrik 2028**, duhet të pajisen me infrastrukturë fizike të gatshme me fibër dhe kabëll deri në pikën fundore të përdoruesit për komunikime me shpejtësi të lartë.
3. Përfshirja e projekteve të infrastrukturës dhe pajisjeve të nevojshme për shtrirjen e rrjetit të komunikimeve elektronike dhe lidhjen e rrjetit të brendshëm me atë të jashtëm, u nënshtrohet rregullave dhe procedurave të legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit

dhe përbën kusht për miratimin e lejes së ndërtimit. Ky detyrim aplikohet dhe në rastet e miratimit të lejeve për punime të rikonstruksioneve, riparimeve, restaurimeve në një godinë biznesi apo banimi.

4. Projektimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së komunikimeve elektronike, duhet të përmbushë të gjitha kërkesat e ligjit për komunikimet elektronike dhe të sigurojë sekretin e komunikimeve, sigurinë, si dhe mosndërhyrjen e infrastrukturave kabllore.
5. Çdo person fizik ose juridik, gjatë paraqitjes së kërkesës për kryerjen e punimeve të ndërtimit apo zhvillimit pranë autoriteteve kompetente, sipas legjislacionit në fuqi për planifikimin dhe zhvillimin e territorit, duhet të sigurojë që dokumentacioni i paraqitur të përfshijë edhe të dhëna për projektimin e pajisjes së ndërtimeve të reja, me infrastrukturën dhe pajisjet e nevojshme për shtrirjen e rrjetit të komunikimeve elektronike.
6. Mosparaqitja e planit për infrastrukturën e rrjetit të komunikimeve elektronike, sipas përcaktimeve të këtij neni, përbën shkak për refuzimin e kërkesës për kryerjen e ndërtimit. Kërkesa e refuzuar për këtë shkak mund të riparaqitet me plotësimin e këtyre kërkesave.

### Neni 31

#### Pika e aksesit për infrastrukturën VHCN në godinë

1. Të gjitha ndërtesat e reja shumëkatëshe ose ndërtesat shumëkatëshe që u nënshtrohen punimeve të mëdha të rinovimit, për të cilat kërkesa për leje ndërtimi, është paraqitur një vit pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, duhet të pajisen me një pikë aksesit në godinë, sipas kërkesave të këtij ligji.
2. Dy vjet nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, të gjitha ndërtesat, përfshirë elementët e tyre në pronësi të përbashkët, që u nënshtrohen rinovimeve të mëdha, duhet të pajisen me infrastrukturë fizike brenda ndërtesës të gatshme për fibra optike dhe instalime me fibra optike brenda ndërtesës, duke përfshirë lidhjet deri në pikën fizike, ku përdoruesi fundor lidhet me rrjetin publik, nëse kjo nuk rrit në mënyrë jo-proporcionale kostot e punimeve të rinovimit dhe nëse është teknikisht e realizueshme. Të gjitha ndërtesat shumëkatëshe që u nënshtrohen rinovimeve të tilla të mëdha, duhet të pajisen gjithashtu me një pikë aksesit në godinë.
3. Autoriteti planifikues kompetent, në momentin e miratimit të lejes së ndërtimit, siguron që të gjitha ndërtesat shumëpërdorimëshe, godina me shumë apartamente banimi ose struktura me disa biznese, të jenë të pajisura me pikë aksesit për infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve të kapaciteteve të larta (VHCN). Ky detyrim aplikohet në rastet e miratimit të lejeve për rikonstruksionet, riparimet apo rindërtimet, që kërkojnë leje ndërtimi, sipas legjislacionit në fuqi.
4. Me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës, mund të përcaktohen përjashtime nga detyrimet e parashikuara në pikën 1 dhe 2, të këtij neni, për kategoritë e ndërtesave, si banesa të veçanta, të vetme, ose për punime rinovuese të mëdha, në rastet kur përmbushja e këtyre detyrimeve nuk është proporcionale me kostot për individët ose bashkëpronarët, ose për lloje të ndërtesave të tilla, si: kategori të veçanta të monumenteve, ndërtesa historike, shtëpi të pushimit, ndërtesa ushtarake, ndërtesa të tjera të përdorura për qëllime të sigurisë kombëtare.
5. Përjashtimet e përcaktuara me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas pikës 4, të këtij neni, duhet të jenë të arsyetuara dhe të konsultohen paraprakisht, me palët e interesuara, të cilave u

jepet mundësia për të dhënë mendimet e tyre për këto përjashtime, në përputhje me ligjin për njoftimin dhe konsultimin publik.

6. Rregullat dhe kërkesat për infrastrukturën e brendshme të godinave dhe të administrimit të pikës së aksesit në godinë, për rrjetet e komunikimeve elektronike të kapaciteteve të larta (VHCN), përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e ministrit përgjegjës.
7. Mos respektimi i kërkesave për infrastrukturën e detyrueshme sipas nenit 30, të këtij ligji, si dhe për pikën e aksesit në godinë, dënohet me gjobë sipas parashikimeve në nenin 39, të këtij ligji.

### **Neni 32**

#### **Standardet për infrastrukturën dhe pikën e aksesit në godina**

1. Autoriteti rregullator në konsultim me palët e interesuara dhe në bazë të praktikave më të mira të industrisë, miraton specifikimet teknike përkatëse të nevojshme për zbatimin e kërkesave të këtij ligji në lidhje me infrastrukturën e rrjeteve të komunikimeve elektronike dhe pikën e aksesit në godina.
2. Standardet ose specifikimet teknike, duhet të lejojnë lehtësisht aktivitetet e zakonshme të mirëmbajtjes për instalimet individuale me fibra të përdorura nga secili operator, për të ofruar shërbime të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN) dhe përcaktojnë të paktën:
  - a) specifikimet e pikës së aksesit të ndërtesës dhe specifikimet e ndërfaqes me fibra optike;
  - b) specifikimet e kabllave;
  - c) specifikimet e prizave;
  - d) specifikimet e tubacioneve ose mikro-kanaleve;
  - e) specifikimet teknike të nevojshme për të parandaluar interferencat me kabllot elektrike;
  - f) rrezet minimale të lakimit të fibrës;
  - g) specifikimet teknike për instalimin e kabllave.
3. Për të siguruar përputhshmërinë me standardet ose specifikimet teknike të përmendura në pikën 2, të këtij neni, autoriteti rregullator bashkëpunon me autoritetet kompetente për inspektimin në vend të ndërtesave, ose një pjese përfaqësuese të tyre.
4. Ndërtesat e pajisura me pikat e aksesit në godinë sipas këtij ligji dhe mbi bazë vullnetare, aplikojnë pranë AKEP për të marrë etiketë "Gati për fibra". Etiketa "Gati për fibra", vendoset në ndërtesat që kanë përmbushur kërkesat sipas nenit 30 dhe 31, të këtij ligji, në përputhje me standaret dhe specifikimet teknike të miratuara.

### **Neni 33**

#### **Aksesi në infrastrukturën fizike të ndërtesave**

1. Çdo sipërmarrës i rrjeteve publike të komunikimeve elektronike, sipas parashikimeve të nenit 31, të këtij ligji, dhe pa çënuar të drejtat e pronësisë, ka të drejtë të ndërtojë me shpenzimet e veta, rrjetin e tij, deri në pikën e aksesit në infrastrukturën fizike në godinë.
2. Çdo sipërmarrës, sipas parashikimeve të nenit 31, të këtij ligji, ka të drejtën e aksesit në infrastrukturën fizike ekzistuese në godinë, me qëllim ofrimin e elementeve të rrjetit të

- komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë (VHCN), nëse dublikimi është teknikisht i pamundur ose ekonomikisht joefiçent.
3. Çdo subjekt që administron pikën e aksesit dhe të infrastrukturës fizike brenda ndërtesës, sipas legjislacionit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesat e banimit, duhet të plotësojë të gjitha kërkesat e arsyeshme për akses në pikën e aksesit në godinë dhe në infrastrukturën fizike të ndërtesës, të bëra me shkrim nga operatorët e rrjetit të komunikimeve publike, sipas termave dhe kushteve të drejta dhe jodiskriminuese, përfshirë, kur është e përshtatshme, edhe çmimin për përdorim. Termat dhe kushtet e të drejtës së përdorimit përcaktohen në marrëveshje ndërmjet palëve.
  4. Nëse marrëveshja e aksesit, e përmendur në pikën 3, të këtij neni, nuk arrihet brenda 30 ditëve nga data e kërkesës për akses, sipërmarrësi i komunikimeve elektronike ka të drejtë t'i drejtohet AKEP-it. Për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, AKEP-i bashkëpunon me ministrin dhe njësinë e qeverisjes vendore përkatëse, sipas legjislacionit në fuqi.
  5. Në mungesë të infrastrukturës fizike brenda ndërtesës së gatshme për fibra, çdo operator i rrjetit të komunikimeve publike, ka të drejtë të ndërtojë rrjetin e tij deri në ambientet e përdoruesit, mbi bazën e një marrëveshjeje me të, me kusht që ndërtimi i rrjetit deri në pikën fundore të tij të ketë ndikim minimal në pronën private të palëve të treta.
  6. Ky nen nuk çënon të drejtën e pronës së pronarit të pikës së aksesit ose infrastrukturës fizike brenda ndërtesës, kur mbajtësi i së drejtës për të përdorur atë infrastrukturë ose pikë aksesit nuk është pronari i saj dhe nuk çënon të drejtat e pronës së palëve të tjera të treta, siç janë pronarët e tokës dhe pronarët e ndërtesës.
  7. Për dëmet që mund të shkaktohen si rezultat i ushtrimit të të drejtave të parashikuara në këtë nen, pronari i tokës apo pronari i ndërtesës, ka të drejtën për t'i kërkuar operatorit kompensim të përshtatshëm financiar, në përputhje me dispozitat e Kodit Civil dhe legjislacionit në fuqi.
  8. Çdo veprim, nga ana e subjektit ndërtues në një godinë të re, apo e administratorit të godinës me bashkëpronësi, që kufizon të drejtën për akses, sipas parashikimeve të këtij neni, të një sipërmarrësi që ofron apo është i autorizuar të ofrojë rrjete dhe/ose shërbime të komunikimeve elektronike, apo të drejtën e çdo përdoruesi, banues në godinë, për të zgjedhur sipërmarrësin e komunikimeve elektronike, është i ndaluar dhe denohet me gjobë sipas parashikimeve në nenin 39, të këtij ligji.
  9. Brenda një viti nga hyrja në fuqi e këtij ligji, pas konsultimit me palët e interesuara dhe me autoritetet përgjegjëse në nivel qendror dhe vendor në fushën e administrimit të pronës së përbashkët, si dhe me AKEP, ministri përgjegjës miraton udhëzime mbi termat dhe kushtet e aksesit në infrastrukturën fizike brenda ndërtesës, duke përfshirë zbatimin e termave dhe kushteve të drejta dhe të arsyeshme, si dhe kriteret që duhet të ndjekin organet kompetente gjatë zgjidhjes së mosmarrëveshjeve.

## **KREU IX**

### **DIGJITALIZIMI I PIKAVE TË VETME TË INFORMACIONIT**

#### **Neni 34**

#### **Detyrimi për të krijuar dhe mbajtur të dhënat për rrjetin**

1. Çdo sipërmarrës i rrjeteve të komunikimeve elektronike publike krijon, mban dhe përditëson një regjistër me informacion të detajuar për infrastrukturën dhe rrjetin e komunikimeve elektronike të zotëruar prej tij.
2. Format i standardizuar dhe përmbajtja e regjistrit, sipas kërkesave të këtij ligji, përcaktohen nga

AKEP-i dhe integrohen në Sistemin e Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike.

3. Informacioni i përfshirë në regjistër i përcillet AKEP-it për publikim në faqen e tij zyrtare.

4. Sipërmarrësit janë të detyruar të raportojnë tek AKEP-i, të gjitha ndryshimet në informacionin e paraqitur gjatë njoftimit, brenda 30 ditëve nga kryerja e tyre.

### **Neni 35**

#### **Sistemi i Përqendruar i Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike**

1. AKEP-i është institucioni përgjegjës për ngritjen dhe administrimin e Sistemit të Përqendruar të Informacionit për rrjetet e komunikimeve elektronike, i cili ndërvepron me sistemet e tjera të informacionit për infrastrukturën fizike sipas këtij ligji.
2. Sistemi i Përqendruar i Informacionit përfshin regjistrin elektronik, me të dhënat e përcjella nga sipërmarrësit, sipas përcaktimeve të nenit 34, të këtij ligji, dhe përditësohet me informacionin e ri të ardhur prej sipërmarrësve.
3. AKEP-i kërkon informacion edhe nga organet shtetërore apo entet publike që kanë në pronësi pronë të shtetit, të cilat përbëjnë infrastrukturën të përshtatshme për shtrirjen e rrjetit të komunikimeve elektronike, dhe e publikon atë.
4. Faqja zyrtare e internetit e AKEP-it përfshin, por pa u kufizuar në të, informacionin lidhur me:
  - a) njoftime për ndërtimet në infrastrukturë, të përshtatshme për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike;
  - b) të dhëna për të gjitha infrastrukturën e përshtatshme për shtrirjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike;
  - c) procedurat dhe kushtet që zbatohen për aksesin dhe përdorimin e infrastrukturave të përshkruara në këtë nen;
  - ç) procedurat dhe kushtet e përfitimit nga rregullat e përdorimit të përbashkët;
  - d) zhvillimin e procedurave të konsultimit publik;
  - dh) vendimet e autoriteteve përgjegjëse, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
  - e) tarifën përkatëse të aplikueshme;
  - ë) çdo informacion tjetër, lidhur me ndërtimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike, që vlerësohet i domosdoshëm për publikim nga AKEP-i.
5. Sipërmarrësit që kanë përfshirë të drejtë kalimi kanë detyrimin të përcjellin informacion të përditësuar, në lidhje me rrjetet dhe infrastrukturën e zotëruar prej tyre, sa herë që u kërkohet nga AKEP-i. Informacioni i kërkuar përfshin të gjitha elementet e nevojshme për t'u përfshirë në Sistemin e Përqendruar të Informacionit.

### **Neni 36**

#### **Akresi në Sistemin e Përqendruar të Informacionit**

1. Sistemi i Përqendruar i Informacionit mbështetet në parimin e transparencës, shpërndarjes së informacionit, reciprocitetit dhe proporcionalitetit. Sistemi do të jetë i hapur për akses në informim për sipërmarrësit e komunikimeve elektronike dhe subjektet e tjera të interesuara, sipas rregullave të miratuara për funksionimin e sistemit.
2. Rregulla më të detajuara për subjektet e autorizuar për akses në sistem përcaktohen me rregullore të AKEP-it.
3. Brenda dy vjetësh nga hyrja në fuqi e këtij ligji, AKEP merr masa për sigurimin e ndërveprimit të Sistemit të Përqendruar të Informacionit, me sistemet e tjera në përmbushje të kërkesave të pikës 1, të nenit 35, të ligji.

**KREU X**  
**AUTORITETET KOMPETENTE DHE MASAT**

**Neni 37**  
**Autoritetet kompetente**

1. Autoriteti Rregullator për Komunikimet Elektronike dhe Postare, AKEP është organi rregullator përgjegjës për marrjen e vendimeve me kërkesë të një operatori, dhe në zbatim të këtij ligji mbi të drejtat dhe detyrimet e operatorit të rrjetit dhe organit të sektorit publik që ofron infrastrukturë fizike, sipas përcaktimeve të këtij ligji.
2. AKEP është autoriteti rregullator i pavarur që ushtron detyrat rregullatore brenda fushës së kompetencës së përcaktuar në këtë ligj dhe ligjin për komunikimet elektronike dhe shërbimet postare dhe merr vendime rregullatore të pavarura mbi baza objektive, transparente, proporcionale, pa diskriminim, sipas përcaktimeve në ligjin për komunikimet elektronike.
3. Në zbatimin e dispozitave të këtij ligji, AKEP bashkëpunon me autoritetet e tjera përgjegjëse dhe organet rregullatore, që kanë në fushën e vet të kompetencës sipas ligjeve të posaçme, rregullimin e veprimtarisë së operatorëve të tjerë të rrjetit, të cilët disponojnë infrastrukturë fizike të përshtatshme për vendosjen e elementëve të rrjeteve të komunikimit elektronike të kapaciteteve të larta. AKEP bashkëpunon me institucionet përgjegjëse për zbatimin e administrimit të bashkëpronësisë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve të lidhura me aksesin në infrastrukturën në ndërtesa.
4. Autoritetet përgjegjëse sipas pikës 3, të këtij neni, bashkëpunojnë me AKEP në veçanti për sa më poshtë:
  - a) sigurimin e saktë dhe në kohë të informacionit të nevojshëm dhe opionit teknik, rregullator të nevojshëm sipas rastit;
  - b) caktimin e një pike kontakti për komunikimet në vazhdimësi me AKEP në lidhje me zbatimin e këtij ligji;
  - c) shkëmbimin periodik të informacioneve mbi çështje rregullatore dhe të rëndësishme që lidhen me sektorin përkatës dhe infrastrukturën fizike, sipas këtij ligji;
5. Bashkëpunimi sipas këtij neni, nuk ndikon në autonominë apo pavarësinë e vendimmarjes së organeve rregullatore apo institucioneve përgjegjëse në fjalë që ushtrojnë kompetencat sipas ligjeve të posaçme.

**Neni 38**  
**Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Çdo palë ka të drejtë t'i drejtohet Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në rastet e mëposhtme:
  - a) kur aksesin në infrastrukturën fizike refuzohet, nuk jepet përgjigje, ose nuk arrihet marrëveshje mbi termat dhe kushtet, përfshirë çmimin, brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës për akses;
  - b) të drejtat dhe detyrimet për transparencë dhe dhënie informacioni në përputhje me kërkesat e ligji;
  - c) kur marrëveshja për koordinimin e punimeve civile nuk arrihet brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës për këtë qëllim;
  - ç) kur marrëveshja për aksesin në infrastrukturën fizike në godinë, nuk arrihet brenda një muaji nga data e marrjes së kërkesës për këtë qëllim.

2. AKEP, në ushtrimin e kompetencave të tij, merr vendim, duke u bazuar në parimin e proporcionalitetit dhe legjislacionin në fuqi, brenda:
  - a) katër muajve nga paraqitja e kërkesës për mosmarrëveshjet që lidhen me refuzimin e aksesit në infrastrukturë;
  - b) një muaji për mosmarrëveshjet e tjera.
 Këto afate mund të zgjaten, vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe mbi bazën e një vendimi të arsyetuar.
3. AKEP, kur është e nevojshme, mund të përcaktojë terma dhe kushte të drejta dhe të arsyeshme, përfshirë çmimin e aksesit, duke garantuar:
  - a) mbulimin e drejtë të kostove;
  - b) një fitim të arsyeshëm
  - c) respektimin e konkurrencës së ndershme dhe efektive.
4. Në rastet kur mosmarrëveshja përfshin operatorë të sektorëve të tjerë të rregulluar, AKEP bashkëpunon dhe konsultohet me autoritetet përkatëse rregullatore, sipas ligjeve të posaçme në fuqi, të cilat përcaktojnë veprimtarinë e autoritetit përgjegjës.
5. Në rastin e mosmarrëveshjeve që lindin në zbatim të neneve 30, 31 dhe 33, të këtij ligji, për aksesin në infrastrukturën në ndërtesa dhe pikën e aksesit në godinë, AKEP bashkëpunon me autoritetet përgjegjëse sipas ligjit në fuqi për administrimin e bashkëpronësisë në ndërtesa.
6. Rregullat dhe procedurat për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve në zbatim të këtij ligji, miratohen me Vendim të Këshillit të Ministrave.
7. Kjo dispozitë nuk çënon të drejtën e palëve për t'iu drejtuar gjykatës, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Palët në proces kanë të drejtën që ta adresojnë çështjen në gjykatë, në rast të mospërgjigjes nga ana e autoritetit rregullator, si dhe kanë të drejtë të ankimojnë në gjykatë çdo vendim të autoritetit për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, në përputhje me përcaktimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe ligjeve të posaçme.

### Neni 39 Gjobat

1. Shkeljet e mëposhtme, kur nuk përbëjnë vepër penale përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me gjobë si më poshtë:
  - a) kur operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike sipas këtij ligji, refuzon pa shkak kërkesën për akses në infrastrukturën e tij, me qëllim ndërtimin e elementeve të rrjeteve të komunikimeve elektronike me kapacitet të lartë, në kundërshtim me parashikimet e këtij ligji, në vlerën nga 100 000 deri në 200 000 lekë;
  - b) kur operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik që ka në pronësi ose kontrollon infrastrukturë fizike sipas këtij ligji, nuk siguron informacionin minimal për infrastrukturën fizike të tij dhe nuk mundëson verifikimin në vend, sipas parashikimeve të neneve 9 dhe 10, të këtij ligji, në vlerën nga 200 000 deri në 400 000 lekë;
  - c) kur operatori i rrjetit ose organi i sektorit publik që kryen punime civile, nuk përmbush detyrimet që lidhen me koordinimin e punimeve civile, sipas nenit 12, të këtij ligji, në vlerën nga 300 000 deri në 500 000 lekë;
  - ç) kur nuk përmbushen detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e nenit 15, të këtij ligji, në vlerën nga 100 000 deri në 500 000 lekë;
  - d) kur sipërmarrësi i komunikimeve elektronike nuk përmbush detyrimin për krijimin e regjistrit me informacionin përkatës, sipas parashikimeve të nenit 34, të këtij ligji, në vlerën nga 200 000 deri në 400 000 lekë;

- dh) kur nuk përmbushen detyrimet që rrjedhin nga parashikimet e nenit 31 dhe 33, të këtij ligji, në vlerën nga 100 000 deri në 500 000 lekë;
2. Në vendosjen e gjobave, sipas këtij neni, do të merren parasysh:
- a) faktimi i shkeljes;
  - b) rëndësia dhe kohëzgjatja e kundërvajtjes;
  - c) rrethanat e kryerjes së kundërvajtjes;
  - ç) nëse kundërvajtësi rezulton i dënuar administrativisht edhe më parë;
  - d) pasojat që kanë ardhur nga veprimi apo mosveprimi.
3. Gjoha është titull ekzekutiv, që vendoset nga autoriteti përgjegjës, i cili mbikëqyr veprimtarinë e subjektit që kryen shkeljen. Si rregull, për të njëjtën shkelje administrative nuk mund të aplikohet më shumë se një gjobë. Gjohat duhet të jenë efektive, proporcionale dhe të arsyetuara. Gjoha mblidhet nga autoriteti që e vendos atë dhe derdhet në Buxhetin e Shtetit.
4. Procedura e konstatimit, vendosjes dhe e ekzekutimit të gjobave, bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për kundërvajtjet administrative.

#### **Neni 40** **Ankimi**

1. Kundër dënimit me gjobë, sipas këtij ligji, bëhet ankimi, fillimisht tek autoriteti që e ka vendosur gjobën, brenda 15 ditëve nga data e dhënies së saj.
2. Kundër vendimeve të autoritetit, sipas pikës 1, të këtij neni, mund të bëhet ankimi në gjykatën përkatëse, brenda 30 ditëve nga marrja e vendimit.

### **KREU XI** **DISPOZITA TË FUNDIT**

#### **Neni 41** **Nxjerrja e akteve nënligjore**

1. Ngarkohet Këshilli i Ministrave të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të pikës 8, neni 12, pikës 4, neni 22, pikës 4 dhe 6, neni 31, pikës 6 neni 38, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
2. Ngarkohet ministri përgjegjës për të nxjerrë aktet nënligjore në zbatim të nenit 8, pika 6, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.
3. Ngarkohet AKEP të nxjerrë aktin nënligjor, në zbatim të pikës 2, të nenit 36, brenda 12 muajve nga hyrja në fuqi e këtij ligji.

#### **Neni 42**

Ligji nr. 120/2016, "Për zhvillimin e rrjeteve të komunikimeve elektronike të shpejtësisë së lartë dhe sigurimin e së drejtës së kalimit", shfuqizohet.

#### **Neni 43** **Hyrja në fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.